



Z. Sokol Havolli është emëruar Zëvendësgovernator për Mbikëqyrje Financiare në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës më datën 1 korrik 2018 nga Bordi i BQK-së. Në këtë pozitë, ai është i ngarkuar për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, të cilat operojnë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë bankat, fondet pensionale, kompanitë e sigurimit, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Në të njëjtën kohë, z. Havolli është edhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të BQK-së.

Z. Havolli në vitin 2006 ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa një vit më vonë përfundoi studimet e magjistraturës në Staffordshire University në Britani të Madhe. Në po të njëjtin universitet, në vitin 2014, z. Havolli përfundoi studimet e doktoratës në fushën e ekonomikut.

Në vitin 2007, z. Havolli filloi punën në pozitën Ekonomist në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ku pas dy viteve u promovua në pozitën Ekonomist i Lartë në kuadër të Departamentit për Analiza Ekonomike dhe Stabilitet Financiar. Në sajë të angazhimit dhe kontributit për zhvillimin e departamentit, në vitin 2013, z. Havolli u promovua në pozitën Zëvendës drejtor i Departamentit për Analiza Ekonomike dhe Stabilitet Financiar, me ç'rast në periudha të caktuara ka ushtruar edhe funksionin e Drejtorit të Departamentit.

Që nga viti 2009, z. Havolli ka ligjëruar në disa universitete në Kosovë lëndë të fushës së ekonomikut dhe financave. Ndërsa, në periudhën 2014-2017, z. Havolli ka shërbyer si këshilltar për politika ekonomike në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Z. Sokol Havolli në vitin 2008 është shpallur fitues i çmimit prestigjioz për ekonomistët e rinj “Olga Radzyner Award” të dhënë nga Banka Kombëtare e Austrisë. Po ashtu, në vitin 2011 ka fituar çmimin e UNDP-së për studimin më të mirë në fushën e dërgesave të emigrantëve.

Z. Havolli është autor dhe bashkautor i një numri të konsiderueshëm të punimeve shkencore të publikuara në revista dhe institucione prestigjioze. Është bashkautor në disa libra të fushës së ekonomisë, duke përfshirë: “Ekonomia e Kosovës”, libër i publikuar në vitin 2018, ndërsa në vitin 2013 ka qenë bashkautor në librin “Dërgesat e emigrantëve dhe zhvillimi në Ballkanin Perëndimor:

Rasti i Maqedonisë, Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës”. Z. Havolli ka marrë pjesë edhe në përkthimin e njërit ndër librat më me influencë në fushën e ekonomiksit dhe bankingut modern, “Ekonomiksi i Parasë, Bankingut dhe Tregjeve Financiare” të autorit Frederick Mishkin.

Ka marrë pjesë në shumë konferenca dhe seminare profesionale e shkencore në nivel vendor dhe ndërkombëtar të organizuara nga institucione financiare ndërkombëtare dhe banka qendrore të vendeve të ndryshme.